

Angazhohu Monitoro Vepra



SUPLEMENT I GAZETËS NOSITI NGA GRUPI MONITORUES I TË RINJVE POGRADEC, DHJETOR 2013

“Gjithçka në një vend demokratik fillon me lejen nga publiku dhe ekziston nga miratimi publik. Nëse kjo është e vërtetë, do të thotë që institucionet (publike ose jo) duhet me kënaqësi t’i tregojnë publikut politikën e tyre, çfarë ata janë duke bërë dhe çfarë shpresojnë të bëjnë për t’u shërbyer sa më mirë atyre. Kjo praktikisht është një obligim” Arthur W. Page.



- ALEGORIA E QEVERISJES SË MIRË DHE E QEVERISJES SË KEQE.....faqe 2
- PROJEKTI “ANGAZHOHU-MONITORO VEPRO”faqe 3
- VULLNETARIZMI, NJË HAP MË TEJ DREJT DIJES!faqe 4
- REDUKTO - RIPERDOR - RICIKLO.....faqe 5
- BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR DHE MË TEJfaqe 6
- TA PASTROJMË SHQIPËRINË NË NJË DITË.....faqe 7
- 16 DITË AKTIVIZËM KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVEfaqe 8



Alegoria e qeverisjes së mirë dhe e qeverisjes së keqe

David MILER

Lexoni, ju lutem, këto 20 a 30 radhë sqaruese, të cilat, edhe pse me alegori, na e thonë hapur se ç'është një qeveri dhe një qeverisje e mirë apo e keqe; pse një projekt qeverisës qoftë edhe ai që nis mbarë e mirë, fillon të lodhet, pastaj korruptohet, lëngon dhe më në fund tradhton dhe shembet; cili është portreti i qeveritarit të mirë dhe atij të keq; si virtytet dhe veset e tij bëhen pjesë e qeverisjes; ç'duhet dhe ç'mund të presim prej kësaj qeverie dhe se çfarë mund të bëjmë apo të mos ia lejojmë vetes ne, si shtetas, që dashje pa dashje bëhemi pjesë a prekemi nga qeverisja e mirë apo nga më e keqja. Ky tekst teorik, i shkruar jo duke na pasur parasysh pikërisht ne, vlen edhe për ne, sigurisht.

Dua t'ia nis duke folur për një pikurë madhështore që do të na ndihmonte të krijojmë një ide më të qartë për atë se çfarë është filozofia politike. Piktura në fjalë u realizua diku mes viteve 1337 dhe 1339 nga Ambrogio Lorenzetti dhe mbulon tre faqe muri të Sala dei Nove të Palazzo Pubblico në Siënë. Vepra në fjalë njihet me titullin "Alegoria e qeverisjes së mirë dhe qeverisjes së keqe" dhe në të, para së gjithash përshkruhet natyra e qeverisjes së mirë e të keqe, përkatësisht përmes shëmbëlltyrave që simbolizojnë cilësitë që duhet dhe nuk duhet të kenë sundimtarët, dhe së dyti, paraqiten pasojat që shkaktojnë këto dy lloj

qeverisjesh në jetën e njerëzve të thjeshtë. Kështu, në pjesën ku përshkruhet qeverisja e mirë shohim sundimtarin e denjë të veshur me petka të shtrenjta e të ulur në fronin e tij, në mesin e shëmbëlltyrave të viryeteve, si Guximi, Drejtësia, Zemërgjerësia, Paqja, Vetëpërmbytja dhe Urtësia.

Poshtë tij shihet një radhë qytetarësh të rrethuar prej një manteli të gjatë, cepat e të cilit janë lidhur në kyçet e sundimtarit, si për të simbolizuar lidhjen e harmonishme të tij me popullin. Kur e hedhim vështrimin në të djathtë shohim se si Lorenzetti përshkruan ndikimet e qeverisjes së mirë së pari në qytet, e më pas nëpër rrethinat e tij. Qyteti paraqitet i sistemuar e i begatë: shihen zejtarë që ushtrojnë zejete tyre, tregtarë që blejnë e shesin mallra, bujarë që kalërojnë kuaj të stolisur zotërisht; diku më tej, një grup valltarësh kërcëjnë kapur dorë për dorë. Jashtë portës së qytetit, një zonjë e veshur mirë që ka dalë për gjah hipur mbi kalin e saj, duke ecur përgjatë rrugës has një derr të majmë që po e çojnë në treg; nëpër ara bujqit punojnë

tokën dhe mbledhin prodhimet e saj. Në qoftë se një vëzhgues i pavëmendshëm nuk do të arrinte ta kapte kumtin e afreskut, nuk ka problem, sepse kumti gjendet i shkruar në një bajrak që mbahet lart prej një krijese me krahë që simbolizon Sigurinë: Pa pasur fare frikë, gjithkush mund të udhëtojë lirisht dhe çdonjëri mund të punojë tokën e ta mbjellë atë, për sa kohë që sovranë e kësaj bashkësie është kjo zonjë, ngase ajo ia ka hequr pushtetin nga dora të ligjve.

Afresku në krahun tjetër, i cili përshkruan qeverisjen e keqe, është mirëmbajtur më pak, por kumti i tij është po kaq i qartë: një sundimtar djallëzor i rrethuar prej veseve si Koprancia, Mizoria dhe Krenaria, një qytet nën pushtim ushtarak dhe fushat përreth qytetit të shkretuara prej ushtrive fantazma. Këtu, mbishkrimi që mbahet prej shëmbëlltyrës së Frikës lexon si më poshtë: Për shkak se gjithkush kërkon veç të mirën vetjake, në këtë qytet Drejtësia ka rënë viktimë e tiranisë; ja përse askush nuk kalon këndeji pari pa pasur frikë për jetën e tij, ngaqë ndodhin grabitje brenda dhe jashtë portave të

qytetit. Nuk ka ilustrim më shprehës për të kuptuar se çfarë është filozofia politike dhe përse na nevojitet ajo, se sa muralja e mrekullueshme e Lorenzetti. Mund ta përkufizojmë filozofinë politike si një hulumtim të natyrës, shkaqeve dhe pasojave të qeverisjes së mirë e të keqe, dhe duhet thënë se piktura në fjalë jo vetëm e përmbledh më së miri këtë kërkim, por edhe shpreh në një formë pamore mbresëlënëse tre nocionet që përbëjnë thelbin e kësaj shkence.

Së pari, qeverisja e mirë apo e keqe ndikon ndjeshëm në cilësinë e jetëve njerëzore. Lorenzetti na rrëfen se si mbretërimi i drejtësisë dhe viryeteve të tjera i jep mundësi njerëzve të thjeshtë për të punuar, tregtuar, dalë për gjah, vallëzuar, pra përgjithësisht për të bërë tërë ato gjëra që e pasurojnë jetën tonë, ndërsa në anën tjetër të pikturës, tirania ngjiz veç varfëri dhe vdekje. Pra, ky është nocioni i parë: jetët tona mund të ndryshojnë në varësi të qeverisjes së mirë apo të keqe. Nuk mund t'ia kthejmë shpinën politikës, të tërhiqemi në jetën private, apo të mendojmë se mënyra se si qeverisemi nuk do të ketë pasojë serioze në lumturinë tonë.

Nocioni i dytë është se forma aktuale e qeverisjes nuk është e parapërcaktuar: qeverisja merr atë formë që i japim (domethënë kemi mundësi zgjedhjeje lidhur me të). Tek e fundit, përse e bëri autori këtë pikurë murale?

Përktheu nga origjinali anglisht Elton Tahirllari



TRAJNIME

Angazhohu - Monitoro- Vepro



Në ambientet e shoqatës “Unë, Gruaja”, Pogradec u realizua trajnimi me temë: “Qeverisja Vendore dhe Instrumentet e Demokracisë Pjesëmarrëse”.

Ky aktivitet është bashkëpunim i Korpusit të Paqes dhe kësaj shoqate, në kuadër të projektit “Ndërgjegjësohu-Monitoro-Vepro”, i cili synon të nxisë pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrjen lokale nëpërmjet një grupi aktiv të rinjsh. Ky grup të rinjsh, bashkë me vullnetarët e

tjerë të shoqatës do të monitorojnë në muajt në vijim mbledhjet e Këshillit Bashkiak Pogradec dhe do të nxisin qytetarët të jenë pjesëmarrës në këto mbledhje dhe të delegojnë tek të zgjedhurit lokalë shqetësime dhe problemet e tyre.

Trajneri Dorian Leka u përqëndrua në temat si “Çfarë dimë mbi Institucionet? Institucionet Publike, Organizimi i Pushtetit Vendor, Qeverisja Vendore: Të Drejtat, Kompetencat

dhe funksionet e Organeve të Qeverisjes Vendore; Instrumentet e Demokracisë Pjesëmarrëse; Këshilli Bashkiak; E Drejta e Informimit etj.

Vullnetarja e Korpusit të Paqes në Pogradec Aleksandra Strzemko u foli të rinjve për vullnetarizmin, dobinë e tij, sa perceptohet vullnetarizmi nga komuniteti ynë dhe më gjerë, si mund të përfshihen sot të rinjtë në aktivitete vullnetare në ndihmë të komunitetit të tyre. Ajo solli për të rinjtë eksperiencën e punës me shoqatën “Unë, Gruaja” në angazhimin e vullnetarëve edhe në projekte sociale, ku shtresat më të marginalizuara të shoqërisë

mbështeten nëpërmjet ligjit dhe mekanizmave të ndryshme të ngritura në bazë të tij, ku përfshihen institucionet shtetërore dhe organizata të shoqërisë civile.

Gjatë sesionit të dytë të trajnimit të rinjtë ndaluan për të drejtuar pyetjet e tyre mbi “Instrumentet e Demokracisë Pjesëmarrëse dhe Efektiviteti i Tyre”. Kjo solli edhe shkëmbimin e mendimeve të tyre në opionencë me njëri-tjetrin.

Trajnuesi Leka ndau me të rinjtë edhe eksperiencën vetjake mbi vullnetarizmin dhe monitorimin e Këshillit Bashkiak, në një projekt të realizuar suksesshëm në 10 edicione të gazetës Nositi.



TË RINJTË QË KANË MARRË PJESË NË MONITORIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK

- | | |
|------------------|-------------------|
| 1. Blerina Qose | 6. Klediana Gjyli |
| 2. Andi Shkëmbi | 7. Kledi Gjyli |
| 3. Asja Leka | 8. Zarife Beçoku |
| 4. Tea Shkëmbi | 9. Asije Ali |
| 5. Eriselda Paho | 10. Floresha Ali |

Si të raportojmë pas monitorimit të Këshillit Bashkiak

Në ambientet e shoqatës “Unë, Gruaja”, Pogradec u realizua trajnimi me temë: “Raportimi i monitorimit në media”, me trajner gazetarin e njohur të mediave shqiptare Ben Andoni.

Ky trajnim u bë në vijim të trajnimeve të mëparshme që synojnë ngritjen e kapaciteteve të një grupi të rinjsh pogradecarë. Ata do të aftësohen të monitorojnë mbledhjet e këshillit Bashkiak, si dhe të nxisin qytetarët për një pjesëmarrje sa më aktive në vendimmarrjen lokale, duke deleguar tek të zgjedhurit lokalë shqetësimet dhe problemet e tyre.

Ky aktivitet është bashkëpunim i Korpusit të Paqes dhe shoqatës “Unë, Gruaja”, në kuadër të projektit “Ndërgjegjësohu-Monitoro-Vepro”.

Trajneri Ben Andoni u ndal në temat si “Shkrimi dhe raportimi i lajmit. Si të monitorojmë Këshillin Bashkiak, Platforma e monitorimit, Si të jesh një gazetar i pavarur dhe i paanshëm, etika në gazetari, etj,

“Përfaqësuesja e Korpusit të Paqes në Pogradec Aleksandra Strzemko u foli të rinjve mbi rëndësinë që ka media në demokraci dhe si mund ta përdorin atë për të bërë transparente ndaj qytetarëve, vendimet e pushtetit vendor.

Gjatë sesionit të dytë të trajnimit të rinjtë ndaluan për të drejtuar pyetjet e tyre mbi shumë aspekte të raportimit në media.



VULLNETARIZMI

Vullnetarizmi, një hap më tej drejt dijes!

Përfaqësuesit e shoqatës “Unë, Gruaja” së bashku me grupin e ri të vullnetarëve vizituan Bibliotekën “Mitrush Kuteli” për të dhuruar setin me libra “ Nancy Drew Mystery Stories”. Ky aktivitet u realizua me iniciativën e Constance Garrels (Koni) vullnetares së Korpusit të Paqes pranë shoqatës tonë gjatë periudhës 2009-2010. Ky set librash është ndër më të lexuarit në Amerikë, në letërsinë e fëmijëve. Nëpërmjet këtij akti synojmë të sensibilizojmë qytetarët e Pogradecit dhe veçanërisht të rinjtë për rëndësinë dhe vlerën që ka libri.

Lexoni më poshtë letrën dërguar tek “Pocahontas”, gazeta lokale e qytetit të Konit



I dashur Redaktor,

Kjo letër vjen nga Shoqata “Unë, Gruaja” në Pogradec, Shqipëri. Është hera e tretë që ne shkruajmë për gazetën tuaj, dhe ju falenderojmë shumë që na e jepni këtë mundësi. Siç edhe e dini, për ju kemi mësuar nga vullnetarja e Korpusit të Paqes Constance Garrels (Connie) e cila ka punuar pranë shoqatës sonë gjatë periudhës (Qershor 2009-Nëntor 2010). Nëpërmjet këtij shkrimi, ne dëshirojmë të informojmë Connie dhe komunitetin tuaj për vazhdimësinë e punës sonë me Vullnetarë të Korpusit të Paqes, si edhe për projektet tona. Aktualisht jemi duke punuar me një vullnetare që vjen nga New York-u, Alexandra Strzempko (Alexa). Alexa është një vajzë e re dhe me shumë dëshirë e pasion për të punuar. Me të jemi duke zbatuar projektin Ndërgjegjësohu- Monitoro- Vepro që mbështetet nga Korpusi i Paqes. Është një projekt që ka në fokus demokracinë lokale e veçanërisht monitorimin e Këshillit Bashkiak. Në këtë projekt do të angazhohen të rinjtë cilët do të trajnohen dhe do të realizojnë takime me komunitetin si dhe monitorimin e

mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Nëpërmjet këtij projekti synojmë përfshirjen e sa më shumë të rinjve në demokracinë lokale si dhe informimin e komunitetit për këshillin bashkiak, rolin e tij dhe rëndësinë e monitorimit të tij. Të martën në datën 23 Korrik u realizua kick off-i i projektit si dhe takimi i parë me grupin e ri të monitorimit të Këshillit Bashkiak. Takimi filloi me intervistimin e grupit, në mënyrë individuale, nga stafi i UG si dhe me shpërndarjen e pyetesorit për të rinjtë. Ky pyetësor kishte si qëllim matjen e njohurive të grupit të ri për Këshillin Bashkiak. Nga pyetësori rezultoi se grupi nuk ka informacion të mjaftueshëm, ose ka pak informacion në lidhje me Këshillin. Por, edhe nga pyetësori të tjerë të shpërndarë në qytet gjatë vitit 2012 ka rezultuar se komuniteti në vetvete nuk ka informacion se kush është këshilli bashkiak, nga se përbëhet dhe cili është roli i tij. Prandaj, e pamë si shumë të nevojshëm realizimin e këtij projekti, i cili do të vazhdojë me punën tonë disa vjeçare si dhe do të ndikojë në rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit për këtë çështje. Prezentë në këtë takim ishin dhe vullnetarë të

shoqatës të cilët kishin qënë pjesë e grupit të monitorimit gjatë periudhës kohore Shtator 2011- Tetor 2012. Pasi u bë prezantimi i projektit Ndërgjegjësohu-Monitoro-Vepro (qëllimi, objektivat, aktivitetet), grupi i ri bëri një bashkëbisedim me anetarët e grupit të vjetër të monitorimit të cilët folën për eksperiencën e tyre gjatë monitorimit si dhe treguan gadishmërinë për të ndihmuar grupin e ri sa herë që ata të kenë nevojë për mbështetje. Të rinjtë vullnetarë më pas vizituan Bibliotekën e qytetit duke dhuruar disa libra në anglisht për departamentin e gjuhëve të huaja. Këto libra, ishin një dhuratë e dërguar nga Amerika, nga vullnetarja e Korpusit të Paqes Connie Garrels për bibliotekën “Mitrush Kuteli”. Seti me libra “Nancy Drew Mystery Stories” është ndër më të lexuarit në Amerikë, në letërsinë e fëmijëve. Nëpërmjet këtij aktiviteti grupi ynë synoi të ndikojë në sensibilizimin e komunitetit, dhe veçanërisht të rinjtë për rëndësinë dhe vlerën që ka libri. Një falenderim i veçantë nga grupi ynë i shkon Connit, e cila nuk na harron asnjëherë, edhe pse është larg vazhdon të japë kontributin e saj për qytetin tonë. Faleminderit Connie, të mbajmë gjithmonë në zemër.



REDUKTO - RIPERDOR - RICIKLO

Të rinj nga shkolla “Gjergj Pekmezi” për mbrojtjen e mjedisit

Pas interesimit maksimal për mbrojtjen e mjedisit nga organizatat e shumta joqeveritare, po rritet interesimi edhe i vetë qytetarëve të Pogradecit për të patur një qytet sa të pastër aq edhe shembullor.

Në mjediset e shoqatës “Unë, Gruaja” një grup të rinjsh nga shkolla Gjergj Pekmezi, të udhëhequr nga mësuesja Irena Kaçori, organizuan një aktivitet sensibilizues për mjedisin.

Stafi i shoqatës prezantoi projektin “Redukto, Ripërdor, Riciklo”. Me këtë projekt shoqata “Unë, Gruaja” synon të sensibilizojë komunitetin e Pogradecit, bizneset e ndryshme, nxënësit e shkollave etj., për të mbrojtur mjedisin duke ricikluar mbetje të ndryshme. Nxënës të shkollave do të angazhohen për të

mbledhur dhe ricikluar letrën “në kushtet e shtëpisë” për ta përdorur më pas për ngrohje duke sensibilizuar së pari familjet e tyre.

Ky grup të rinjsh kanë dalë vullnetarë për të qenë pjesë aktive e këtij projekti duke filluar me grumbullimin e letrës, përpunimin, prodhimin e tullave për djegie deri në shpërndarjen e tyre pranë shkollave që përdorin ngrohje me dru.

Gjithashtu vullnetarja e Korpusit të Paqes, Aleksandra Strzempko, prezantoi disa nga aktivitetet e grupit të të rinjve monitorues të Këshillit Bashkiak në Pogradec dhe shpërndau suplementet e përgatitura në këtë kuadër.

Suksese të rinjve pogradecarë!

Faleminderit për angazhimin dhe përfshirjen tuaj aktive!

PSE DUHET TË RICIKLOJMË?

- Riciklimi ruan burimet natyrore, kursen energji në prodhimin e produkteve të reja dhe zvogëlon ose shmang ndotjen lidhur me nxjerrjen dhe përpunimin e lëndëve të para.
- Riciklimi zvogëlon sasinë e mbetjeve të ngurta që dalin nga proceset e prodhimit për lëndë të parë dhe që përfundojnë në venddepozitim.
- Riciklimi ul shkarkimet në atmosferë të gazeve me efekt serre si dioksidi i karbonit, që kontribuojnë në ndryshimin e klimës globale.
- Të riciklosh ka vlerë ekonomike.
- Riciklimi është një veprim mjedisor.
- Riciklimi ndihmon në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm për një mjedis më të mirë për brezat e ardhshëm.

A JEMI GATI PËR TË FILLUAR NJË PROGRAM RICIKLIMI NË SHKOLLË?

Për të realizuar një program riciklimi të suksesshëm në shkollë nuk ka vetëm një mënyrë. Çdo shkollë mund të ketë veçoritë e saj dhe mund të gjejë rrugët më efikase në realizimin e këtij procesi. Mund të na dalin shumë pyetje në lidhje me këtë çështje por mendojmë se katër prej tyre janë më të rëndësishmet dhe duhet të adresohen që në fillim të këtij procesi.

- Cilat janë mbetjet që mund të riciklojmë në shkollë (p.sh. letër, kanaçe alumini dhe çeliku, shishe plastike, karton)?
- A janë të gjitha mbetjet që mund të riciklohen?
- Si do të mbledhen dhe do të ruhen këto mbetje?
- A ka në qytetin tonë kompani riciklimi dhe a pranojnë mbetjet e mbledhura nga nxënësit?
- Kush do t’i çojë (transportojë) këto mbetje deri tek pika e grumbullimit të kompanisë së riciklimit?



BASHKËPUNIMI NDËRKUFITAR DHE MË TEJ...

Projekti “Përtej Liqenit”

Në kohën në të cilën jetojmë, në një botë me shumëllojshmëri dhe pasiguri të madhe, në të cilën ne duhet të komunikojmë në kuadër të përcaktimeve etnike, fetare, linguistike dhe nacionale, paraqitet nevoja për dialog ndërkulturor si proces i cili përfshin shkëmbimin e hapur dhe të denjë të mendimeve mes individëve, grupeve me prejardhje të ndryshme etnike, fetare dhe linguistike dhe pasurisë kulturore nëpërmjet mirëkuptimit dhe përkrahjes së përbashkët.

Projekti “Përtej Liqenit” është një projekt i inicuar nga “Këshilli Rinor i Ohrit”, me përfaqësues zotin Dimche Kanevche, ndërsa Shoqata “Unë, Gruaja” është partnere dhe merret me koordinimin e grupit të punës për pjesën shqiptare.

Ky projekt u finalizua me përgatitjen e një strategjie për dialog interkulturalor, e cila do të jetë subjekt miratimi nga qeverisja lokale në dy qytetet, Ohër e Pogradec.

Në fokus të kësaj strategjie janë të rinjtë dhe njohja e tyre me karakteristikat themelore historike dhe kulturore si dhe shqetësimet që kanë të rinjtë nga të dyja anët e kufirit.

Fillimisht grupi i vullnetarëve bëri identifikimin e të gjitha institucioneve kulturore, arsimore, si dhe OJF-të e qytetit që punojnë me këtë çështje. Gjatë periudhës përgatitore, u krijua koalicioni joformal me përfaqësues nga këto institucione, të cilët morën



pjesë në këto aktivitete dhe dhanë kontributin e vet në hartimin e kësaj strategjie.

Për më shumë rreth këtij projekti do të njiheni në numrin e ardhshëm.

Vizitorë të rinj pranë “Unë, Gruaja”!

Ditën e martë, datë 17 Shtator mjediset e Shoqatës “Unë, Gruaja” u vizituan nga një grup të rinjsh dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme nga Bolzano Itali. Takimi u organizua nga “Rete Donne Lavoro”, Shqipëri. Gjatë këtij takimi u shkëmbyen eksperiencat nga puna vullnetare në të dy vendet dhe u hodhën ide të reja për bashkëpunime në të ardhmen.



Nga libri i përshtypjeve...

1. Hartmam- Streetworker\ Italia

Punojmë në rrugë, përballë shumë nevojave, ashtu si edhe ju kujdeseni për njerëzit në nevojë. Shumë urime për iniciativat tuaja.

2. Sandra Durnwaldor- Streetworker Itali

Ndiqui gjithmonë ëndrrat tuaja!

3. Genda Gius

Është bukur të takosh gra dhe të rinj, të cilët punojnë me dëshirën për të ndryshuar botën për mirë. Urime dhe komplimenta.

4. Hubert Fischer - Centro Giovani Point-Egna

Faleminderit per mikpritjen!

5. Salvatore Cosentino Streetwork

Faleminderit për dhuratën e çmuar: Kohën dhe entuziazmin tuaj.

6. Michela Abram - Streetwork Merano (BZ) Itali

Përgëzime për punën tuaj!

Shumë suksese për të ardhmen!

7. Franziska Staffler - Centro Giovani Phnix Schluderns

Përgëzime! Po bëni projekte të thjeshta por të rëndësishme! E shoh që i bëni gjërat me pasion dhe po e bëni punën shumë mirë.

8. Verena Hafner

Mu bë shumë qejfi që u njohëm dhe kaluam pak kohë bashkë...

Është bukur gjithmonë të shohësh të rinjtë të zënë me punë.

9. Mauro Dellafiore- Ass La strasa Der WEG- Centro Giovani” TKT Itali

Ishte një shkëmbim experience i shkëlqyer dhe jam i lumtur që takova njerëz plot me dëshirë për të punuar. Shihemi së shpejti!

10. F. Stasi

Ju lumtë. Shikoj tek ju buzëqeshjet dhe dëshirën për t’ia dalë mbanë. Kështu që edhe e ardhmja do të jetë me siguri më e mirë.

Vazhdoni në këtë mënyrë.



TË RINJ AKTIVË, QYTET MË I PASTËR

“22 Nëntor 2013 -Ta pastrojmë Shqipërinë në një ditë!”

Nën slloganin “Mendo Sot për një të Nesërme më të Mirë”, të rinjtë dhe vullnetarët e shoqatës “Unë, Gruaja”, me pankarta sensibilizuese në duar ftojnë bashkëqytetarët t’i bashkohen thirrjes për një qytet më të pastër.

Në një ditë kaq të rëndësishme u bashkua edhe Kryqi i Kuq Shqiptar dhe vajzat e skuadrës së

volejbollit me trajner z. Llazi Kërzhalli për pastrimin e qytetit turistik dhe liqenin e Pogradecit.

Iniciativat sensibilizuese mbeten gjithmonë “dritat jeshile” për banorët e Pogradecit. Shoqata “Unë, Gruaja” në këtë kuadër dëshmon “Një qytet Turistik sa më të Pastër” i cili i thotë çdo ditë “jo” ndotjes së mëtejshme të tij.

Shoqata “Unë, Gruaja” ka ndërmarrë pikërisht këtë protestë sensibilizuese në kuadër “Të pastrojmë Shqipërinë në një ditë” organizuar nga Green Line Albania, një nismë ndërkombëtare kjo, e cila këtë vit po realizohet edhe në Shqipëri, konkretisht në Pogradecin tonë turistik.

Një Pogradec i pastër mbetet “oaz” për të gjithë, jo vetëm për banorët, por edhe për pushuesit. Qytetarët duhet të kujtohen çdo ditë për pastrimin e qytetit të tyre ndaj në këtë kuadër sensibilizimi i “Unë, Gruaja” në Pogradec ka qenë në kohën e duhur këtë 22 Nëntor.



1. Më jep një mbeturinë ta kthej në vepër arti.
2. Njeriu e formon veten përmes vendimeve që formojnë mjedisin.
3. Qytetarë! Mendoni dhe veproni Gjelbër!
4. Mendo Sot për një të Nesërme më të Mirë.



16 DITË AKTIVIZËM KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE

Bashkohuni, për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave!

Mbështetini gratë në të gjithë botën dhe bashkohuni me lëvizjen botërore për paqe. "I jap mirëseardhjen korit të zërave që thërrasin për t'i dhënë fund dhunës, e cila ndikon në 1/3 e grave. Duartrokas dhe i aprovoj udhëheqësit të cilët ndihmojnë në miratimin dhe përforcimin e ligjeve dhe që ndryshojnë mendimet e kundërta. Dhe i shpërblej të gjithë ata heronj në të gjithë botën të cilët i ndihmojnë viktimat të shërohen dhe që bëhen agjentët e ndryshimit."

Ban Ki-moon,

Sekretar i Përgjithshëm i OKB-së

25 Nëntori është Dita Ndërkombëtare e zgjedhur për të theksuar dhunën gjinore, si një kamzhik i rrezikshëm për shëndetin, i cili ndikon në më shumë se një të tretat e grave në të gjithë shoqëritë, në të gjitha klasat shoqërore, në të gjitha kontinentet.

Dhuna nuk njeh kufij gjeografik, kulturor, social, ekonomik apo edukativ.

Shoqata "Unë, Gruaja" për disa vite rresht, është bërë pjesë e Fushatës dhe ka kontribuar për sensibilizimin e komunitetit në rajonin Pogradec-Korçë për dhunën sistematike që shkel dinjitetin dhe personalitetin e gruas. Ajo është pjesë aktive dhe bashkëpunon me të gjithë aktorët e Mekanizmit dhe Trajtimin të Referimit të Rasteve kundër Dhunës në Familje duke gjetur mbështetjen e tyre për t'i thënë JO këtij krimi.



Qëllimi i fushatës ka qenë të rrisë ndjeshmërinë e komuniteteve për ta trajtuar dhunën ndaj gruas si dhunim i të drejtave të njeriut. Fushata është zhvilluar nga grupe të ndryshme në mbarë botën për të kërkuar mbështetje për shërbime ofruar të mbijetuarave, për të rritur përpjekjet parandaluese, për të ushtruar presion për realizimin e reformave ligjore e gjyqësore dhe për të përdorur instrumenta ndërkombëtare për të adresuar dhunën ndaj gruas si dhunim i të drejtave të njeriut, si një krizë e shëndetit publik dhe si kërcënim për sigurinë e paqen në mbarë botën.

Duke filluar nga 25 Nëntori, Dita Ndërkombëtare Kundër Dhunës ndaj Gruas, deri më 10 Dhjetor, Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, njerëz dhe organizata në të gjithë botën janë bashkë me mesazhe dhe aktivitete të përbashkëta, në mbrojtje të të drejtave të grave, si pjesë e të drejtave të njeriut.

Kjo periudhë 16-ditore përfshin edhe data të tjera të rëndësishme si 1 Dhjetorin, Dita Botërore e Luftës Kundër AIDS dhe 6 Dhjetorin që shënon përvjetorin e Masakrës së Montrealit, etj. Fushata 16-ditore është përdorur si strategji nga individë dhe grupe përreth botës për t'i thënë Ndal Dhunës Ndjaj Gruas.

Këtë vit, Fushata 16 Ditë përkujton aktivistet, të cilat e kanë bërë këtë fushatë të suksesshme dhe nderon mbrojtëset e të drejtave njerëzore të grave, të cilat kanë përjetuar kërcënim e dhunë për arsye të aktivizmit të tyre dhe/ose kanë dhënë jetën duke luftuar për barazinë gjinore.

Ky vit shënon progres në adresimin e dhunës ndaj gruas në komunitetet, kombet, rajonet tona e në mbarë botën duke bërë thirrje për të reflektuar mbi faktin se si të vazhdojmë ta avancojmë më tej këtë punë. Ndërkohë që kemi bërë progres në përpjekjet për të ndaluar dhunën ndaj gruas, kemi hasur në shumë sfida. Fushata e këtij viti kërkon të rishikojë dhe të forcojë fokusin e punës për të drejtat e njeriut kundër dhunës gjinore ndaj gruas.

Gjithashtu ajo shpreson të marrë në konsideratë edhe pengesa të tjera të shumta me të cilat përballet gruaja në komunitetet dhe kombet tona e që i shtohen dhunës ndaj gruas, si konfliktet e armatosura, lufta, varfëria, HIV/AIDS, globalizmi dhe sfida të tjera të të drejtave të njeriut.



Të rinj vullnetarë pranë shoqatës "Unë, Gruaja" dhe Zyra për Barazi Gjinore, Bashkia Pogradec duke shpërndarë materiale sensibilizuese në ditën e çeljes së Fushatës Ndërkombëtare kundër Dhunës ndaj Gruas nën moton: "Djemtë dhe burrat, pjesë e zgjidhjes - Tregoni se jeni kundër dhunës!"